



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR SHERBIME
(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, në cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njërën anë;

dhe

NNT “Loshi Design” nga Gurrakoci, Komuna e Istogut, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 70689324 të cilën e përfaqëson, z. Valmir Loshi “Furnizuesi”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim si më poshtë:

FURNIZIMI ME MATERIAL NDËRTIMOR PËR SANIMIN E GJENDJËS NGA FATKEQSITË NATYRORE

Nr. I prokurimit	633 - 19 - 389 -1-2-1/ FA/034
Nr. I brendshëm	633 / 019/ 004-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për sherbimet si në vijim: Furnizimi me material ndërtimor për sanimin e gjendjës nga fatkeqsitë natyrore nga FURNIZUESI siq është përcaktuar në dosjën e tenderit.

FURNIZIMI ME MATERIAL NDËRTIMOR PËR SANIMIN E GJENDJËS NGA FATKEQSITË NATYRORE

Specifikimi I detyrueshem teknik dhe fomulari I çmimeve është pjesë përberese e kontratës dhe e njejti është bazë për pagesen e kontraktorit.

Autoriteti Kontraktues bënë kryerjen e shërbimeve vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek kryersi i shërbimeve, **duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.**

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative Autoritetit Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në Nenin 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKHATËSISHT ME DATË **06.05.2019** DHE DO TË PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **05.05.2021** PASI KONTRAKTORI TE SJELLË DESHMINË MBI SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMËRI PREJ **25 MUAJVE**, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

Neni 2 Koha e perfundimit

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha furnizimeve do të jetë: **05. 04. 2021** si afat I skadimit te afatit te kontratës.

2.2 Vendi i furnizimit KOMUNA E ISTOGUT – urdheresa e Njesise Kërkuese

2.3. Obligimet e kontraktorit janë te gjitha shërbimet të përcaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.4 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.5 Kontrata mund te shkëputet edhe para këtijë mund te shkëputet edhe para ketije afati, po qe se kontrata permbushe me çmim sipas dispozitave te Nenit 56.10 te Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi I tenderit është çmim I poentuar, ndërsa çmimet per njësi janë të paraqitura në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e furnitorit datë: **05. 03. 2019**

Vlera totale 2. vjeqare e kontratës është: **81.730,00 Euro.**

Dhe me shkronja: /Tetëdhjetënjëmijëstatëçindetridhjetëeuro/

3.2 Çmimi i përmendur Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:

NNT "LOSHI-DESIGN"

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Valmir Loshi</i>
Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>Drejtori</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>05/11/19</i>	Data:	<i>05/11/19</i>
Vula:		Vula:	

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 633-19-389-1-2-1

Titulli i kontratës: FURNIZIMI ME MATERIAL NDERTIMOR PER SANIMIN E GJENDJES NGA FATKEQESITE NATYRORE

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 FURNIZIMI ME MATERIAL NDERTIMOR PER SANIMIN E GJENDJES NGA FATKEQESITE NATYRORE

3. Çmimi total i tenderit është:

122,38 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

**Nr.i Prokurimit: 633-19-389-1-2-1///633-019-004-121-Titulli: FURNIZIMI ME MATERIAL
 NDERTIMOR PER SANIMIN E GJENDJES NGA FATKEQESITE NATYRORE
 PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe</i>
Siguria e ekzekutimit	8.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 25 muaj.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Dorëzimi	19.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>